



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 730/25
Dt. 11.07.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe ZPP-së, më dt. 11.07.2025 merë:

V E N D I M

1. Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheri të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Asgjesimi I mbeturinave mjeksore për 36 muaj, me numër të prokurimit: VU644-25-1644-2-2-1**, si vijon :

z.Fisnik Kamberi, emërohet menaxher i kontratës.

z.Naile Gjaka emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me kushtet e Kontratës dhe Porositë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkojë mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpilojë – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm

- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësi dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
 - administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
 - rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.
- 3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorit Ekonomik: **MetBat SH.P.K., Malet e Krivoves, 13050, Drenas, Kosovë****
- Kopje: Menaxheri i Kontratës;
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;

Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtoria të Njësive Kërkuese

Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

VU644-25-1644-2-2-1/C1057

14 Nr. 729/25

Dt. 11.07.2025

KONTRATË SHËRBIMI

(Kontratë Kornizë)

Palët kontaktuese:

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontaktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi -Drejtor i Drejtorisë për Prokurimin Publik** (në tekstin e mëtejshëm **POROSITËSI**), dhe
2. **MetBat SH.P.K., Malet e Krivoves, Drenas**, (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Asgjësimi i mbeturinave medicinale për 36 muaj, me numër identifikues:

Nr1 i prokurimit	VU644-25-1644-2-2-1
Nr i brendshëm	VU644-25-05 -221

Neni 1 Lënda e Kontratës

- 1.1 Lënda e kontratës ka të bëjë me **Asgjësimin e mbeturinave medicinale**, QKMF në Vushtrri, sipas Listes së Përshkrimit të Çmimeve si dhe / ose Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues: VU644-25-1644-2-2-1
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe fillon të zbatuar nga data: **11.07.2025** dhe përfundon në datën **:11.07.2028**
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, kërkon kryerjen e shërbimeve(servisimi i paisjeve të oksigjenit) në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet të dërgojë “porosinë” tek ofruesi i shërbimeve i, duke specifikuar paisjet që do të servisohen.
- 1.4 Sasitë e parapara, në listen e përshkrimit dhe Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative.
- 1.5 Nëse Urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

- 1.6 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë **Asgjësimin e mbeturinave medicinale**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.
- 2.3 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej të gjitha shërbimet me cilësi të lartë dhe me çdo ndryshim siç përcaktohet nga autoriteti kontraktues dhe në pajtim me kërkesat e specifikuara në Specifikimin teknik të Dosjes së Tenderit.
- 2.4 Autoriteti kontraktues, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë..
- 2.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë QKMF Vushtrri.
- 2.6 Dorëzimi konsiderohet i përfunduar pas pranimit dhe konfirmimit të cilësisë së shërbimeve të pranuar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni për pranim të mallrave dhe shërbimeve.
- 2.7 Ofruesi i Shërbimeve do të jetë tërësisht përgjegjës për paisjet, dhe duhet të jetë i siguruar në përputhje me rrethanat. Çdo dëmtim i shkaktuar do të korrigjohet nga ofruesi i shërbimeve në shpenzime të veta.

Dërgesat :

- 2.8 Kryerja e shërbimeve do të fillojnë të bëhen bazuar në kërkesën – porosinë e Menaxherit të Kontratës të A.K. Kryerja e shërbimeve do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit punës të A.K., e hënë/ e premte, 8.00 – 16.00.
- 2.8 Inkotrimi i zbatueshëm do të jetë DDP1 (Dërgesat e Detyrës të Paguar

Neni 3 Çmimi

- 3.1. Çmimet për shërbime janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e dorëzuar nga kryesi i shërbimeve.
- 3.2 Vlera totale indikative e kontratës është **6,180.00** (gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë)
- 3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për shërbime,
- 3.4 DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguar - Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë
- 3.5 Pagesat do të bëhen: në pajtim me shërbimet e kryera dhe të pranuar nga Menaxheri i Kontratës dhe të konfirmuara me Raportin me shkrim.
- Shumat do të paguhën brenda jo me shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është e regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose me shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe kushteve të përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.
- 3.5 Kontraktuesi ka për obligim që shërbimet të jetë cilësore, ti përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.
- 3.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kryesi i shërbimeve të ketë përfunduar gjitha shërbimet e porositura prej Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbehet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshje e kontratës
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike
- Oferta financiare
- Plani për menaxhimin e kontratës, dhe
- dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.




4.2 Dokumentet e ndryshme që përbejnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën, dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

- 5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në kushtet e Veçanta të Kontratës.
- 5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
- 5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj", "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.
- 5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin. Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.


Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna Vushtrri

Për: MetBat SH.P.K., Malet e Krivoves, Drenas

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Nardi Kadriu
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.07.2025	Data:	11.07.2025
Vula:		Vula:	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I Asgjësimi i mbeturinave medicinale për 36 muaj									
1	Mbeturina medicinale (shiringa, gjilpëra, fasha, gaza, pambuk etj.)	kg	3090		18.00	2.00	0.00	6,180.00	6,180.00
TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH							0.00	6,180.00	6,180.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	MetBat SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Nardi Kadriu
NËNSHKRIMI:	
DATA:	01.04.2025
VULA:	